

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISE "Zeven Tech" sh.p.k.

KAPITULLI 1
Dispozita të Përgjithshme

- Jolti Demaj lindur më 07.01.1988, në Përmet, madhor dhe me zotësi për të vepruar, i identifikuar me letërnjoftim nr. **040046273**, dhe nr. Personal **I80107040N**, lëshuar nga Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë.

Ortaku i sipërpërmendur është madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar. I mbështetur në Ligjin nr.9901, dt.14.04.2008, "Për shoqëritë tregtare", i ndryshuar, si dhe në legjislacionin shqiptar në përgjithësi, vendosi sot, me date 03.11.2025, si më poshtë vijon:

Emërtimi, Selia dhe afati i Shoqërisë

Neni 1

Të themelojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, për të zhvilluar veprimtari tregtare. Shoqëria do të jetë person juridik shqiptar, veprimtaria e së cilës do të rregullohet nga akti i themelimit, statuti i saj dhe legjislacioni në fuqi.

Neni 2

Shoqëria do të emërtohet **"Zeven Tech" sh.p.k.**

Neni 3

Selia e shoqërise do të jetë në Tiranë, Rruga "Mustafa Qosja" Pall. 14 , kati 2; Selia e shoqërise mund të transferohet.

Neni 4

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një afat të pacaktuar, i cili mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 5

Aktiviteti i shoqërisë

Shoqëria "Zeven Tech" sh.p.k. do të ketë si objekt veprimtarie:

1. Studime, projekte, trajnime dhe konsulencë teknologjike për zhvillimin e sistemeve software-ike, aplikacioneve web dhe mobile, arkitekturave të cloud computing, zgjidhjeve me inteligjencë artificiale (AI), machine learning (ML) dhe data analytics, për biznese dhe institucione publike/private.
2. Ofrimi i ekspertizës në vlerësimin e ndikimit të teknologjive digjitale në proceset e brendshme, digjitalizimi i proceseve operacionale dhe menaxheriale për kompani, organizata dhe institucione.
3. Zhvillimi i platformave të sigurisë kibernetike, integrimi i sistemeve për parandalimin e sulmeve digjitale (firewall, antivirus, intrusion detection), si dhe zgjidhje për backup dhe disaster recovery.
4. Dhënia me qira e software-ëve.
5. Zhvillimi i platformave për monitorim mjedisor në kohë reale (ajër, ujë, zhurmë), përmes integritit të sensorëve dhe software-ëve për analizimin e të dhënave.
6. Vlerësimi, testimi dhe analizimi i sistemeve software-ike për industrinë.

7. Mbikëqyrja dhe testimi i sistemeve software-ike dhe projekteve digjitale për të gjitha kategoritë e veprimtarive në sektorin publik dhe privat.
8. Implementimi i rrjeteve digjitale, infrastrukturës kompjuterike (LAN/WAN/WiFi), instalimi i server-ëve, shërbimeve cloud, si dhe integrimi me sisteme komunikimi (VoIP, IoT).
9. Instalimi i pajisjeve IT për sisteme të avancuara software-ike dhe hardware-ike: qendra të të dhënave, pajisje për inteligjencë artificiale, rrjete kompjuterike, pajisje industriale të automatizuara.
10. Zhvillimi dhe mirëmbajtja e platformave të telekomunikacionit dhe shërbimeve digjitale të komunikimit përmes software-ëve VoIP, chatbot-ëve dhe video-konferencave.
11. Mirëmbajtja dhe servisi i sistemeve kompjuterike.
12. Import-eksport i materialeve kompjuterike, pajisjeve të rrjetit, pajisjeve të sigurisë kibernetike, si dhe tregtimi i software-ëve të licencuar.
13. Import-eksport i pajisjeve elektronike dhe teknologjike për kontrollin dhe automatizimin e proceseve industriale, platforma smart për qytete të zgjuara (Smart Cities) dhe energji të rinovueshme.
14. Testimi dhe certifikimi i aplikacioneve software-ike dhe sistemeve IT, përputhshmëria me standardet ndërkombëtare si: ISO/IEC 27001, GDPR, HIPAA, etj.
15. Ofrimi i shërbimeve të e-commerce për kompani vendase dhe të huaja.
16. Ofrimi i çdo lloji konsulence dhe shërbimi inxhinierik në fushën e IT-së, përfshirë zhvillimin e software-ëve të personalizuar, aplikacioneve mobile, ERP/CRM, zhvillimin e inteligjencës artificiale, si dhe hartimin e planeve të biznesit dhe menaxhimin e kontratave për klientë dhe projekte ndërkombëtare.

Neni 6

Kur shoqëria pushon veprimtarinë e saj, pas shlyerjes së të gjitha detyrimeve, pjesa e mbetur e kapitalit dhe e të ardhurave i takon ortakëve të saj.

Ortaku themelues përballon humbjet e shoqërisë deri në kufirin e vlerës së kapitalit që ka derdhur në formimin e kapitalit themeltar.

Kapitali bazë mund të rritet nga fitimi, me kontribute në natyrë, ose përmes kredive në lekë apo në valutë, të marra në bankat e shtetit shqiptar.

Kapitali themeltar për vazhdimin e aktivitetit të shoqërisë është 3.000.000,00 LEK që i takon ortakut themelues si më poshtë:

1. Ortaku **z. Jolti Demaj**, lindur më 07.01.1988, në Përmet, madhor dhe me zotësi për të vepruar, i identifikuar me letërnjoftim nr. **040046273**, dhe nr. Personal **I80107040N**, zotëron 2 (dy) kuota me vlerë secila kuotë prej 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë) LEK, dhe vlerë totale **3.000.000,00** (tre milion) LEK, që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

NENI 7

Organi Vendimmarrës

Shoqëria është e organizuar në organet e mëposhtme:

1. Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë
2. Administratori

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë, i cili miraton çdo ndryshim të statutit, sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.


Ortakët mund të përfaqësohen në Asamblenë e Përgjithshme nga një person i tretë, me autorizimin përkatës. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, duke përfshirë edhe mbledhjet pasuese me të njëjtin rend dite.

NENI 8 **Administrimi**

1. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është pesë vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekt pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
2. Personi i mëposhtëm caktohet si administrator i shoqërisë për një afat pesëvjeçar, duke filluar nga data e regjistrimit të kësaj shoqërie pranë QKB-së, dhe do të veprojë me tagra të pakufizuara:
 - Jolti Demaj, shtetas Shqiptar, lindur më 07.01.1988, në Përmet, madhor dhe me zotësi për të vepruar, i identifikuar me letërnjoftim nr. **040046273**, dhe nr. Personal **I80107040N**, i cili, në të njëjtën kohë, ka edhe funksionin e përfaqësimit të shoqërisë ndaj të tretëve në të gjithë veprimtarinë e saj, në mënyrë të pavarur.

Specimeni i firmës së administratorit:

 _____;

NENI 9 **Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë, në këto raste:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në aktin e themelimit të saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse shoqëria nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë, në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”;
- e) me vendim të gjykatës.

Në këto raste, ortakët marrin vendim me shkrim, në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një ose disa likuidatorë. Në çdo dokument të lëshuar prej tyre, duhet të shënohet emri i likuidatorit dhe emërtesa shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendje të aftësisë paguese, përveç rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuidatorët e emëruar nga ortakët.

Nëse ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuidatorëve brenda 30 ditëve nga data e prishjes së shoqërisë, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës për të caktuar një likuidator.

NENI 10
Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet ose të bashkohet me vendim të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

NENI 11
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe me dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodit Civil dhe çdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

NENI 12
Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe palëve të treta, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Ky akt themelimi është përgatitur në dy (2) kopje të barasvlershme, në gjuhën shqipe, me nga 4 faqe secila.

ORTAKU I SHOQËRISË
Jolti Demaj

